



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 qershor 2019  
Nr. ref.:RK 1374/19

## VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

**rastin nr. KI203/18**

Parashtrues

**Afrim Salihu**

**si përfaqësues i pretenduar i L. K.**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Dhomës së Posaçme të  
Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të  
Privatizimit, AC-I-18-0022, të 22 shkurtit 2018**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

## **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Afrim Salihu, avokat nga Prishtina, i cili pretendohet të jetë përfaqësues i L. K. (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesi i pretenduar).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Përfaqësuesi i pretenduar konteston Aktvendimin [AC-I-18-0022] e 22 shkurtit 2018 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes të cilit përfaqësuesi i pretenduar pretendon se L. K., i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 26 dhjetor 2018, përfaqësuesi i pretenduar parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 16 janar 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e pretenduar për regjistrimin e kërkesës dhe bazuar në nenin 21 (Përfaqësimi) të Ligjit dhe rregullin 32 të Rregullores së punës, kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim në procedurën para Gjykatës, si dhe kërkoi nga i njëjti që të plotësoj formularin e kërkesës.
8. Më 29 janar 2019, shkresa e dorëzuar përfaqësuesit të pretenduar, u kthye mbrapa në Gjykatë nga shërbimi postar, pasi që i njëjti nuk gjendej në adresën të cilën paraprakisht e kishte lënë në Gjykatë.
9. Më 28 shkurt 2019, Gjykata përmes postës elektronike ripërsëriti shkresën për përfaqësuesin e pretenduar dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë

autorizimin për përfaqësim në procedurën para Gjykatës dhe që të plotësoj formularin e kërkesës.

10. Më 6 mars 2019, përfaqësuesi i pretenduar, dërgoi në Gjykatë përmes postës elektronike formularin e kërkesës, por jo edhe autorizimin për përfaqësim të kërkuar nga Gjykata.
11. Më 27 maj 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

### **Përmbledhja e fakteve**

12. Gjykata nuk i referohet fakteve të këtij rasti, pasi që kërkesa është parashtruar nga një përfaqësues i pretenduar, i cili nuk ka dëshmuar të ketë autorizim për përfaqësim për të parashtruar këtë kërkesë në Gjykatë në emër të L. K.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

13. Duke qenë se kërkesa është parashtruar nga një përfaqësues i pretenduar, i cili përkundër kërkesave të Gjykatës, nuk ka dorëzuar autorizim të vlefshëm para Gjykatës, kjo e fundit nuk do t'u referohet pretendimeve që supozohet se i përkasin L. K., në mungesë të një autorizimi formal për të bërë një gjë të tillë.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

14. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

16. Gjykata, gjithashtu i referohet nenit 21 [Përfaqësimi] të Ligjit, i cili përcakton:

*“Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala”.*

17. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*“[...]*

*(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:*

*[...] (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor; [...].*

*(3) Nëse pala ka përfaqësues, përfaqësuesi dorëzon në Gjykatë bashkë me kërkesë, autorizim të vlefshëm”.*

18. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që kërkesa është dorëzuar nga një avokat i cili pretendon të jetë i autorizuar për të përfaqësuar L. K. në Gjykatë dhe i cili, përkundër kërkesave të Gjykatës të 16 janarit 2019 dhe 28 shkurtit 2019, respektivisht, nuk ka dorëzuar në Gjykatë autorizimin i cili do të vërtetonte se parashtruesi i kërkesës është autorizuar nga L. K. për të përfaqësuar të njëjtën para Gjykatës.
19. Mosdorëzimi i autorizimit të vlefshëm në Gjykatë i pamundëson Gjykatës shqyrtimin e një kërkesë në pajtim me nenin 21 të Ligjit dhe rregullit 32 të Rregullores së punës.
20. Në dritë të këtyre fakteve, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“[...] (5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze. [...]”.*

21. Në këtë aspekt, Gjykata konkludon se kërkesa është e paplotë dhe nuk është e qartësuar sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar në Gjykatë autorizimin e vlefshëm për përfaqësimin e palës të cilin ai pretendon se e përfaqëson para Gjykatës. (Shih, rastet e Gjykatës nr. KI23/18, parashtrues, *Ismet Kërçagu, si përfaqësues i pretenduar i A. K., M. K., B. K., F. K. dhe A. K.*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 7 shkurtit 2019; nr. KI16/18, parashtrues, *Sahit Musa, si përfaqësues i pretenduar i K. N.*, Vendim për refuzim të kërkesës i 31 dhjetorit 2018; dhe rastin nr. KI30/18, parashtrues, *Sahit Musa, si përfaqësues i pretenduar i N. H., XH. H. dhe S. H.*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 11 qershorit 2018).
22. Rrjedhimisht, Gjykata bazuar në rregullin 35 (5) të Rregullores së punës konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22.4 dhe 47.1 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 27 maj 2019, njëzëri

### VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtarja raportuese

  
Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Arta Rama-Hajrizi